



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

UDHËZUESI DHE PRIORITETET THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIMET 2026

Thirrje për Projekte 2026

Mbështetur në politikat e Bashkisë Durrës për promovimin e artit, kulturës, trashëgimisë dhe sportit, si dhe në vizionin për Durrësin si një qendër kulturore, turistike dhe sportive, Bashkia Durrës në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit Kulturës Rinisë Sporteve dhe Komuniteteve Fetare hap Thirrjen për Projekte për vitin 2026, me qëllim krijimin e një klime mbështetëse për komunitetin artistik, kulturor dhe sportiv, për të gjallëruar jetën kulturore dhe sportive të qytetit, si dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor.

Kush mund të aplikojë?

Thirrja për aplikim për projekte synon të mbështesë financiarisht me projekt-propozime të paraqitura nga:

- Persona juridikë të regjistruar si OJF.
- Persona fizikë të regjistruar në QKB, të cilët kanë në objekt të veprimtarisë së tyre promovimin, mbrojtjen, ruajtjen, përcjelljen dhe digjitalizimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e sportit.

PRIORITETET E THIRRJES

1. Promovimi i artit, kulturës, trashëgimisë kulturore dhe sportit

Bashkia Durrës do të mbështesë projekte që:

- Nxisin krijimtarinë artistike të individëve apo grupeve lokale.
- Mbështesin aktivitete kulturore dhe sportive në ambiente të hapura publike.
- Organizojnë koncerte, festivale, turne sportive dhe gara që përfshijnë komunitetin.

- Përfshijnë aktivitetet kulturore dhe sportive që ruajnë dhe përcjellin vlerat e trashëgimisë kulturore dhe traditave sportive lokale.
- Mbështesin organizimin e aktiviteteve sportive dhe programeve që përfshijnë të rinjtë dhe fëmijët, duke promovuar një stil jete aktiv dhe të shëndetshëm.

TIPOLOGJIA E VEPRIMTARIVE QË MUND TË MBËSHTETEN

Shembuj veprimtarish që mund të mbështeten:

- Koncerte, festivale dhe shfaqje artistike e sportive.
- Panaire dhe ose ekspozita që promovojnë artin, trashëgiminë dhe sportin.
- Organizimi i garave dhe turneve sportive me përfshirjen e komunitetit.
- Projekte që përcjellin vlerat e trashëgimisë kulturore dhe sportive përmes artit dhe teknologjisë.
- Programet edukuese që përfshijnë artin, trashëgiminë dhe sportin, duke përdorur teknologjinë moderne.

TIPOLOGJIA E VEPRIMTARIVE QË NUK FINANCOHEN

Nuk do të financohen projekte që:

- Mbështesin aktivitete politike apo të jashtëligjshme.
- Përdoren për mbulim defiçiti, shpenzime kapitale ose blerje asetesh
- Janë jashtë zonës së mbulimit të projektit ose janë financuar retroaktivisht.

AFATET KOHORE DHE PERIUDHA E REALIZIMIT

Afati i aplikimit: deri më 28 Shkurt 2026.

MËNYRA E APLIKIMIT

- Dokumentacioni dorëzohet në formë të printuar pranë Zyrës së Informacionit të Bashkisë Durrës, në adresën lagjia 1, Sheshi “Liria” Durrës.
- Dokumentacioni mund të dorëzohet edhe elektronikisht në adresën info@durres.gov.al.

VIZIBILITETI

Projektet e mbështetura duhet të evidentojnë në çdo rast përkrahjen financiare të Bashkisë Durrës dhe të përfshijnë logon e saj në materialet promovuese.

Le të bashkojmë forcat për një Durrës më kreativ, të pasur me kulturë dhe tradita, si dhe më aktiv në sport!